



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROÇEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 757 Prot.

Tiranë, më 11 / 09/ 2014

Lënda : Dërgohen rekomandime për marrjen e masave për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim, në fillimin të vitit shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor parauniversitar.

Drejtar : **Znj. Lindita NIKOLLA**
MINISTRE E ARSIMIT DHE SPORTIT

TIRANË

E nderuar zonja Ministre!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) ka ndjekur në vazhdimësi situatën në sistemin arsimor parauniversitar, me një ndjeshmëri akoma më të madhe në fillimin e çdo viti shkollor.

Gjithashtu, gjatë veprimitarise së tij ka identifikuar problematika të ndryshme me të cilat përballen grupe dhe kategori nxënësish, si ata romë dhe egjiptianë, LGBT, me aftesi të kufizuara, fëmijët që për shkak të gjakmarrjes nuk mund të arsimohen apo ata nxënës që për shkak të kushteve të vështira ekonomike apo vendbanimit, përballen me vështirësi, deri në pamundësi për t'u arsimuar. Ekziston një legjislacion dhe akte nënligjore, politika dhe strategji, ku parashikohen detyrime për të gjithë institucionet e përfshira në procesin e arsimimit, por, gjatë veprimitarise së tij Komisioneri ka konstatuar se, në disa raste situatat



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

diskriminuese kanë ardhur si rezultat i mosnjohjes së kuadrit ligjor në fuqi dhe përrjedhojë e moszbatimit, ose e keqzbatimit të tij.

Në bazë të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka nxjerrë një sërë aktesh nënligjore zbatimi i të cilave së bashku me aktet, masat dhe planet e veprimit që janë në fuqi në mënyrë efektive është i domosdoshëm për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në fushën e arsimit.

Sa më sipër, institucioni i Komisionerit në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpëra ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin **dhe** bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të shkronjës “f”, të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

1. Nxjerra e akteve nënligjore në zbatim të nenit 18 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në nenin 39, pika 2, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet detyrimi i Këshillit të Ministrave, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 18, të ligjit.

Në bazë të Urdhrit të Kryeministratit, nr. 52, datë 23. 04. 2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është ngritur grupi i punës për hartimin e akteve nënligjore. Në bazë të këtij urdhëri, ky grup pune drejtohej nga Ministria e Arsimit. Komisioneri, bazuar në urdhrin e mësipërm ka ndjekur si vëzhdues mbledhjet e grupit të punës, që janë zhvilluar gjatë vitit 2012, por njëkohësisht ka dërguar me shkrim edhe disa rekomandime.

Aktualisht nuk kemi asnjë informacion lidhur me punën e këtij grupi ndërinstitucional dhe konkluzionet që kanë dalë nga puna e grupit. Nuk rezulton që deri në këto momente të kenë dalë aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të ligjit, si një detyrim detyrimi ligjor i parashikuar nga neni 39, pika 2, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Sa më sipër, kërkojmë informacion lidhur me hapat e ndërmarra nga grupi ndërinstitucional i punës, i cili kryesohet nga Ministria e Arsimit, i ngritur në bazë të urdhrit të Kryeministratit nr. 52, datë 23. 04. 2012 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, lidhur me hartimin e këtyre akteve nënligjore.

2. Amendimi i rregullores tip të institucionit arsimor parauniversitar, me qëllim përcaktimin e një procedure për shqyrtimin e ankesave për diskriminim në sistemin arsimor.

Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, konkretisht nenit 19, të këtij ligji, drejtuesit e institucionit arsimor kanë detyrimin ndër të tjera që të shqyrtojnë brenda një afati prej 30 ditësh nga paraqitja, ankesat për diskriminim në institucionin që ata drejtojnë. Nga veprimtaria e deritanishme e institucionit dhe kontaktet që kemi patur me shkollat, qoftë gjatë shqyrtimit të ankesave që janë paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, por edhe gjatë aktiviteteve që Zyra e KMD-së ka realizuar në disa institucione të arsimit parauniversitar, rezulton se në rregulloret e brendshme të shkollave nuk ka parashikime lidhur me ndjekjen dhe shqyrtimin e ankesave për diskriminim.

Nga përbajtja e Udhëzimit të Ministrat të Arsimit dhe Shkencës nr. 30 datë 02.08.2013 “Për rregulloren tip të institacioneve arsimore”, nuk ka parashikime lidhur me shqyrtimin e ankesave për diskriminim që mund të paraqiten si nga nxënësit ashtu edhe nga ana e mësuesve.

Sa më sipër, *rekomandojmë* që udhëzimi nr. 30 datë 02.08.2013 “Për rregulloren tip të institacioneve arsimore”, të amendohet me qëllim që të përfshihen në rregulloren tip të institacioneve arsimore, parashikime për mënyrën e shqyrtimit të ankesave për diskriminim.

3. Ndërgjegjësimi për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit. Këto detyrime janë parashikuar në nenin 18 të ligjit. Një ndër detyrimet e ministrisë është edhe rritja e



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

ndërgjegjësimit për ligjin. Nga ana e Ministrisë së Arsimit deri më sot nuk është ndërmarrë ndonjë fushatë ndërgjegjësimi për ligjin. Ky nen përcakton se veçanërisht ndërgjegjësimi për ligjin duhet të bëhet nëpërmjet përfshirjes në programet mësimore të informacioneve mbi ligjin.

Sa më sipër, *rekomandojmë* që të ndërmerret një fushatë kombëtare për të rritur ndërgjegjësimin në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar për detyrimet që burojnë nga ligji për mbrojtjen nga diskriminimi si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, si përbushje e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga neni 18 i ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”. Lidhur me këtë institucioni i Komisionerit shpreh gadishmérinë për të asistuar ministrinë në realizimin e një nisme të tillë duke vënë në dispozicion specialistë nga Zyra e Komisionerit për Mbrotjen nga Diskriminimi.

Sjellim në vëmendjen tuaj se në kuadër të priorititetit 5, “*Të merren masa efikase për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshi mbrojten e romëve dhe politikat antidiskriminim, si edhe të zbatohen të drejtat e pronësisë*”, një nga objektivat është “*sigurimi i zbatimit efikas dhe rritja e ndërgjegjësimit publik për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”*”. Në kuadër të përbushjes së këtij objektivi Ministria e Arsimit ka marrë përsipër detyrimin dhe konkretisht masa 1.8, që brenda shtatorit 2014 të zbatojë rekondimet e Komisionerit për Mbrotjen nga Diskriminimi dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (aktualisht Ministria e Arsimit dhe Sporteve) me shkresën Prot. 367, date 01.07.2013, në lidhje me masat për eliminimin nga programet studimore të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, të literaturës që diskriminon dhe paragjykon të drejtat e komunitetit LGBT.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ka vendosur detyrime jo vetëm për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, por edhe për drejtuesit e institucionit arsimor, por përsëri ai nuk është cituar si një nga ligjet mbi bazën e të cilët realizohet veprimtaria e institucionit arsimor, në udhëzimin nr. 23 datë 08.08.2014 “*Për vitin shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor parauniversitar*”. Përfshirja e ligjit si një nga aktet mbi bazën e të cilët duhet të realizojnë veprimtarinë e tyre institucionet arsimore, do të ishte një mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin për ligjin. Për më tepër kur në udhëzimin nr. 23 datë 08.08.2014, kreu II, pika 2, gërmë “a”, parashikohet detyrimi që e gjithë baza ligjore që citohet në udhëzim t’i vihet në dispozicion DAR/ZA.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Sa më sipër, *rekomandojmë* që të merren masat e duhura për të vënë në dispozicion të DAR/ZA së bashku me bazën ligjore që është përfshirë në udhëzimin nr. 23 datë 08.08.2014, edhe një kopje të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”. Gjithashtu rekomandojmë që në vazhdim ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” të bëhet pjesë e bazës ligjore që listohet në udhëzimin e ministrit për çdo fillim viti shkollor.

Gjithashtu, në mënyrë të veçantë DAR/ZA, duhet të kujdesen që në të gjitha *institucionet arsimore të afishojnë në një vend të dukshëm një kopje të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, si një detyrim ky që rrjedh nga nen 19, gërmë “a” e ligjit.

4. Çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuentimit në shkolla, lidhur me fëmijët romë dhe egjiptianë.

Në këtë fillim viti të ri shkollor 2014-2015, kërkohet zbatimi me efikasitet dhe monitorimi nga ana e Drejtorive Arsimore Rajonale të gjithë kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, strategjive dhe politikave, për të bërë të mundur regjistrimin e fëmijëve romë/egjiptian për vitin e ri shkollor. Regjistrimi i tyre duhet të bëhet pranë njësive vendore ku ata banojnë pavarësisht nëse ata janë të regjistruar apo jo në gjendjen civile të asaj njësie, apo edhe në rastet kur ata nuk janë të regjistruar në gjëndje civile. Në asnjë rast nuk duhet të refuzohet regjistrimi i një fëmije që ka mbushur moshën e detyrimit shkollor.

Në zbatim të detyrimeve që dalin edhe nga Plani Kombëtar i Veprimit të Dekadës së Përfshirjes Rome, 2010-2015, DAR/ZA duhet të zbatojnë dhe monitorojnë të gjitha masat e përcaktuara *për të evidentuar numrin e fëmijëve romë*, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar, *sipas largësisë së qendrës së banimit me shkollën* dhe të bëjnë propozimet pranë institucioneve përgjegjëse *për sigurimin e transportit falas* për këta fëmijë.

DAR/ZA duhet *të ndjekin në vazhdimësi frekuentimin shkollës* nga ana e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe *ndryshimin e raportit* mes nxënësve që i përkasin këtyre komuniteteve dhe atyre që nuk i përkasin, në shkollat që kanë numër më të madh të fëmijëve të komunitetit rom/egjiptian, për të parandaluar në këtë mënyrë krijimin e zonave apo shkollave, të cilat frekuentohen vetëm nga fëmijë të komunitetit rom/egjiptian. Një kujdes i posaçëm duhet të tregohet gjatë krijimit të klasave të para apo në rastet e



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

ristrukturimit të klasave, për të shmangur veçimin apo segregimin e fëmijëve romë në klasa të caktuara, duke krijuar në këtë mënyrë klasa vetëm me fëmijë romë.

5. Subvencionimi i teksteve shkollore

Vitin e kaluar, për shkak të vonesës në subvencionimin e testeve shkollore, u shkaktua një situatë problematike për kategoritë e nxënësve si, romë, egjiptianë, fëmijët që gjëzojnë statusin ligjor të jetimit dhe statusin e të verbërit, fëmijët e emigrantëve dhe pakicave kombëtare, fëmijët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, apo kategori të tjera të, cilët përfitojnë subvencion nga shteti për tekstet shkollore.

Për përmirësimin e situatës arsimore të minoritetit rom, në Planin Kombëtar të Veprimit të Dekadës së Përfshirjes së Rome, 2010-2015, është marrë përsipër detyrimi për sigurimin e teksteve dhe mjeteve shkollore falas për fëmijët romë. Nisma e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit duke porositur shtëpitë botuese që të përgatisin libra shkollorë, sipas klasave, falas, për të gjithë fëmijët romë, pa qenë e nevojshme të paguajnë për t'u rimbursuar më pas nga shteti, mund të lehtësojë pajisjen me tekste të fëmijëve. Megjithatë siç rezulton edhe nga një monitorim i zyrës së Observatorit për të Drejtat e fëmijëve, procesi i shpërndarjes së teksteve shkollore falas për fëmijët e komunitetit rom, viti shkollor 2014-2015, në qarqe të ndryshme, ka rezultuar me problematika. Nga ky monitorim rezulton se në qarqe të ndryshme ndiqen praktika të ndryshme lidhur me pajisjen e fëmijëve me tekste shkollore falas.

Për mbarëvajtjen e këtij procesi është e nevojshme që **Ministria e Arsimit dhe Sportit të unifikojë praktikën** që duhet të ndiqet për pajisjen e fëmijëvë romë me tekste shkollore falas, dhe **të njoftojë të gjitha DAR/ZA** lidhur me praktikën që duhet të ndjekin.

Duke marrë shkas nga eksperiencia e vitit të kaluar, por edhe nga zhvillimet e deritanishme lidhur me këtë proces, **rekomandojmë ndjekjen dhe monitorimin me prioritet të gjithë procesit për subvencionimin e teksteve shkollore**, për të gjithë kategoritë e fëmijëve që përfitojnë subvencionimin e teksteve shkollore, për të garantuar pajisjen e të gjithë nxënësve me tekstet shkollore dhe për të parandaluar në këtë mënyrë krijimin e situatave diskriminuese për këto kategori nxënësish, të cilët do të gjendeshin në pamundësi për t'u pajisur me tekstet shkollore.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

6. Krijimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare për vlerësimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Gjatë vitit të kaluar shkollor institucioni i Komisionerit, ka konstatuar disa raste kur për shkak se këto komisione nuk kishin filluar funksionimin, nxënësit me aftësi të kufizuara nuk pranoheshin në shkollat e zakonshme. Shkollat nuk duhet të refuzojnë ndjekjen e shkollës së zakonshme nga nxënësit me aftësi të kufizuara, nëse paraprakisht nuk është bërë vlerësimi i nevojave të nxënësit nga komisioni multidisiplinar, i cili të ketë vendosur se fëmija duhet të ndjekë një shkollë të specializuar. Në të dyja rastet, si refuzimi apriori pa u bërë vlerësimi nga komisioni multidisiplinar, ashtu edhe ndjekja e shkollës pa patur një plan edukativ individual për nxënësin me aftësi të kufizuara, i vendos këta fëmijë në kushte të pabarabarta me të tjerët dhe përbën diskriminim. Në çdo rast ndjekja e shkollës së zakonshme nga nxënësi me aftësi të kufizuara duhet të bëhet në baza të Planit Edukativ Individual (PEI).

Me përparësi rekmandojmë krijimin dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për vlerësimin e nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me garantimin e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duhet që të mbahet në vëmendje edhe **detyrimi** për të ndërmarrë masat e duhura (modifikime apo ndryshime) **për të realizuar përshtatjet e arsyeshme**, qoftë infrastrukturore qoftë masa të tjera në procedura apo orare, sa herë që do të jetë e domosdoshme. Mohimi i përshtatjes së arsyeshme përbën diskriminim sipas nenit 3, pika 7, të ligjit ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’.

7. Marrja e masave nga drejtuesit e institucioneve arsimore për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në shkolla

Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të udhëzojë në mënyrë të posaçme DAR/ZA, për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme masat e marra nga drejtuesit e institucioneve arsimore për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në shkolla, mënyrën e trajtimit të sjelljeve dhe qëndrimeve homofobike, stigmatizuese ndaj nxënësve që i përkasin komunitetit LGBT, nxënësve të përkatësisë rome dhe egjiptiane, nxënësit me aftësi të kufizuara, por jo vetëm, si dhe mënyrën e trajtimit të ankesave për diskriminim nga ana e



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

drejtuesit të institucionit arsimor, një detyrim ky i parashikuar nga neni 19, gërmë “ç”, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj, do të vlerësonim maksimalisht përgjigjen tuaj lidhur me masat e marra për adresimin e rekomandimeve të mësipërme, brenda një afati kohor të arsyeshëm.



Konc', Klodiane



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al